



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 720/1 Prot.

Shkodër, më 14.11.2023

**Lënda:** Mbi Vendimin Nr. 79, datë 30.10.2023 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

**KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale përcaktuar në dispozitat e ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, KPAD neni 112, ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, analizoi vendimin **Nr. 79, datë 30.10.2023 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës** “Për korrigjim gabimi material te VKB Nr.62/2020 miratim plani lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve bashkia Vau Dejës 2020-2022 për periudhën 2020-2025, sipas dokumentacionit konfirmues i marrë nga website i bashkisë Vau Dejës“.

Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**PREFEKTI**

**Majlinda ANGONI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr. 79 Datë 30.10 2023

**“PËR NJË KORRIGJIM GABIMI MATERIAL NË VENDIMIN NR. 62, DATË  
26.10.2020 TË KËSHILLIT BASHKIAK “PËR MIRATIMIN E “ PLANIT LOKAL TE  
MENAXHIMIT TE MBETJEVE E TE NGURTA URBANE , BASHKIA V AU DEJES  
2020-2022”**

Në mbështetje të Ligjit nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë; Ligji nr 10563, datë 22.09.2019 “ Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar; VKM nr 175 dt 19.01.2011 “ Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”; Udhëzimit nr 1738 dt 12.03.2015 “ Mbi kriteret e studim projektimit për rehabilitimin e vendepozitimeve të trajnimit të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e landfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane” , i propozojmë Këshillit të Bashkisë, të:

**VENDOSI:**


1. Korrigjimin e emërimit të vendimit Nr 62 , datë 26.10.2020 të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës dhe pikës 1 të këtij vendimi, si më poshtë :  
**Ishte:** “Për miratimin e “ planit lokal te menaxhimit te mbetjeve e te ngurta urbane , bashkia vau dejes 2020-2022”  
**Bëhet:**  
“Për miratimin e “ planit lokal te menaxhimit te mbetjeve te ngurta urbane , bashkia vau dejes 2020-2025”
2. Ky korrigjim bëhet për shkak të gabimit material në hartimin e Vendimit nr 62, datë 26.10.2020.



3.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” .

Sekretar i Këshillit Bashkiak  
Ardian ÇELEPIJA

Kryetari i Këshillit  
Ervis SHIMAJ



Miratuar me 17 vota

Vota Pro 17

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 03.11.2023

